



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 71/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 11.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN si te pasafatshme ankesat me numër lënde A nr. 71, A nr. 72, A nr. 73, A nr. 74, A nr. 75, A nr. 76 dhe A nr. 77 të datës 10.01.2011, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar 7 ankesa më datë 10.01.2011, nga subjekti politik LVV, ne te cilat pretendohet se më datë 09.01.2011:

A nr. 71- Ne Vendvotimin (VV) 2114/01r, fshati Runik komuna e Skenderajt, vëzhguesin e LVV Xhevhet Dumishi nuk e kanë lejuar të flasë me komisionarët dhe vëzhguesit e tjerë të LVV-së. Në këtë fshat nuk është lejuar që të merren shënime prej vëzhguesve, pasi janë kontrolluar fletët dhe janë kërcënuar, nga kryesuesi i VV-se Agim Durmishi. Sipas parashtruesit të ankesës në këtë fshat janë kërcënuar vëzhguesit e subjektit LVV edhe nga Rrahim Rama i cili ka pasur dy ID kartela, njëra e komisionarit ndërsa tjetra e vëzhguesit. Kohë pas kohe ai ka kaluar edhe si komisionar. Po ashtu nga militantët e PDK-së janë bllokuar 7 persona të LVV të cilët për shkak të parregullsive e kanë lëshuar VV, mirëpo janë bllokuar në dalje. Në këtë fshat ka pasur prani të vogël të policëve të cilët nuk kanë marrë masa ndaj personave të cilët i kanë bllokuar personat e LVV-së. Me këtë konsiderohet se është bërë shkelje e nenit 160 par. 1 dhe 3 dhe neni 162 par.1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK).

A nr. 72 -Në këtë ankesë theksohet se në orën 17:53 një votuese ka votuar dy herë. Kjo është vërejtur edhe nga vëzhguesi i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Bashkim Gashi dhe nga vëzhguesi i organizatës Demokracia në Veprim. Kjo shkelje është regjistruar në librin e vërejtjeve. Më këtë konsiderohet se është bërë shkelje e nenit 178 (KPK).

A nr. 73 - Në këtë ankesë theksohet se më datë 09.01.2011 në fshatin Açarevë komuna e Skenderajt 2104b ka pasur votime në emër të personave tjerë. Në emër të Zizë Bajramit, ka votuar djali i saj Sefer Bajrami dhe në emër të Naile Bajrami ka votuar Sylë Bajrami. Kjo parregullsi ka ndodhur për shkak se është lejuar prej anëtarit të KVV-së Halil Behrami përfaqësues i subjektit politik LDD. Me këtë konsiderohet se është bërë shkelje e nenit 178 të KPK-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratën e dëshmitarit Selman Sokolaj.

A nr. 74- Në këtë ankesë theksohet se “në fshatin Polac i Ri komuna e Skenderajt në QV 2107b/04R vëzhguesi i LVV-së është kërcënuar gjatë gjithë ditës nga Daut Veliu i cili i ka treguar armën. Kjo ka ndodhur në shenjë frikësimi për vëzhguesin. Po ashtu në këtë qendër kanë votuar edhe fëmijë. Më këtë konsiderohet se është bërë shkelje e nenit 161 par.1 të KPK-së”. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur edhe deklaratën e dëshmitarit Burim Gashi.

A nr. 75- Në këtë ankesë theksohet se me datë 09.01.2011, në fshatin Turiquevc komuna e Skenderajt në shkollën fillore “Abedin Rexha” në VV 2117B/02d, një votues ka votuar 6 herë. Komisionari i kësaj klase nuk e ka lejuar vëzhguesin Besart Abazi nga subjekti politik LVV të komunikoj me vëzhguesit e zyrës Amerikane duke iu kërcënuar se “kur të dalësh jashtë s’ke me pas punën mirë me neve”. “Vëzhguesit e subjektit politik LVV kanë dashur ta lëshojnë VV për shkak të parregullsive por nuk janë lejuar”. Në këtë rast konsiderohet se është bërë shkelje e nenit 178 të KPK-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur edhe deklaratat e dëshmitarëve Besart Abazi dhe Arbënor Dehari.

A nr. 76- Në këtë ankesë theksohet se “zyrtari për identifikim Petrit Babaj nuk kontrollonte me llampë, rrinte jashtë dhe lejonte të hynin njerëz pa u bërë kontrolli i nevojshëm. Kjo ndodhi pa ndërprerje që nga ora 17:45 deri në mbylljen e VV në ora 19:00”;

A nr. 77- Në këtë ankesë theksohet se “në orën 19:00 në fshatin Leqinë komuna e Skenderajt në shkollën fillore “Ali Kelmendi” Qendra e Votimit 21132/03R, në kabinën e votimit është gjetur lista e kandidatëve të subjekteve politike në të cilat shihet qartë se në fletët e LVV-së e cila iu shërben votuesve për ti zgjedhur kandidatët, fleta ka qenë e kapur në atë mënyrë që votuesi nuk ka mundur ti shoh numrat e kandidatëve. Përveç kësaj fletët e lartcekur kanë qenë të formatit A2 që nënkupton që nuk ka qenë e njëjtë me fletët tjera të listës së kandidatëve të subjekteve politike”.

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon se:

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është pranuar ankesa.

PZAP gjeti se:

- ankesat janë te pasafatshme

PZAP-i duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore ka gjetur se ankesat janë të pasafatshme për shkakun se këto ankesa janë pranuar prej PZAP me datë 10.01.2011 në ora 19:07, ndërsa afati për ti parashtruar këto ankesa ka qenë deri më datë 10.01.2011 në ora 19:00. Parashtruesi i ankesave nuk e ka shfrytëzuar afatin që ka qenë në dispozitën e lartcekur ligjore. Për këtë arsye si dhe bazuar ne dispozitën ligjore të cituar me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 71/2010 më datën 11.01.2011

